



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-22324

Dt.16.11.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Kisha Katolike "Shën Pjetri e Shën Pali"** dhe **Kuvendi Franqeskan në Gjakovë**, përmes famultarit Nue Kajtazi – me banim në **Gjakovë - I Autorizuar sipas Aktit Noterial – Autorizim, me numër LRP nr.1229/2017, i datës 24.03.2017**, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit me destinim - Objekti i përkujdesit ndaj pleqëve, në kuadër të kompleksit të Kishës Katolike "Shën Pali e Shën Pjetri" në Gjakovë, objektit me etazhitet **B+P+1**, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: aplikuesit: **Kisha Katolike e "Shën Pjetri e Shën Palit"** dhe **Kuvendi Franqeskan në Gjakovë**, përmes famultarit Nue Kajtazi – me banim në **Gjakovë - I Autorizuar sipas Aktit Noterial – Autorizim, me numër LRP nr.1229/2017, i datës 24.03.2017**, ndërtimi i objektit me destinim - Objekti i përkujdesit ndaj pleqëve, në kuadër të kompleksit të Kishës Katolike "Shën Pali e Shën Pjetri" në Gjakovë, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Vendimin për Kushte Ndërtimore, me numër 07-351/01- 2816, të datës 02.08.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale ndërtimore me numër 3206/3, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të "Sekretariati Federativ për mbrojtje popullore – Kuvendi Franqeskan - Kisha Katolike Gjakovë (shfrytëzues 99 vite), e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhitet i objektit është **B+P+1**, në sipërfaqe të përgjithshme (bruto) te objektit për këtë fazë: **S=2318.80 m²**

Bodrumi:	(Sip,Bruto):	S=751.6 m²
Përdhesa:	(Sip,Bruto):	S=810.2 m²
Kati i parë:	(Sip,Bruto):	S=751.60 m²

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit fetar me destinim – Objekti i përkujdesit ndaj pleqëve, në kuadër të kompleksit të Kishës Katolike "Shën Pali e Shën Pjetri" në Gjakovë nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë byroja projektuese "KORONA – ING" - Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar original të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë për Punë Inspektuese, për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit të lokacionit të piketuar.
- Për Objektet e kategorisë së dytë, Investitori duhet që për secilën fazë të ndërtimit, të parashtojë kërkesë, pranë Drejtorisë për Punë Inspektuese, me qëllim të Inspektimit dhe përcjelljes së realizimit të punimeve nga secila fazë, si dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për lëshimin e Certifikatës - Lejes së Përdorimit të objektit.

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.



Arsy etim

Kisha Katolike "Shën Pjetri e Shën Pali" dhe Kuvendi Franqeskan në Gjakovë, përmes famultarit Nue Kajtazi, i lindur në fshatin Karashëngjergjaj, Komuna e Prizrenit, me banim në Gjakovë - I Autorizuar sipas Aktit Noterial – Autorizim, me numër LRP nr.1229/2017, i datës 24.03.2017 Bashkësisë Islame në Gjakovë, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM-së, me nr. 07/351/01-22324, të datës 25.10.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit me destinim - Objekti i përkujdesit ndaj pleqëve, në kuadër të kompleksit të Kishës Katolike "Shën Pali e Shën Pjetri" në Gjakovë, objektit me etazhitet B+P+1, në ngastrën kadastrale ndërtimore me numër 3206/3, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të "Sekretariati Federativ për mbrojtje popullore – Kuvendi Franqeskan - Kisha Katolike Gjakovë (shfrytëzues 99 vite), siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Kopjen e planit të datës 08.02.2017, në pronësi të në pronësi të në pronësi të "Sekretariati Federativ për mbrojtje popullore – Kuvendi Franqeskan - Kisha Katolike Gjakovë (shfrytëzues 99 vite), lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
2. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me numër të lëndës 400/17 dt.08.02.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Planin e Situacionit në përpjesë 1:1000, të datës 15.09.2017, i punuar nga N.SH.K.e M"GEO-DD" Gjakovë, dhe e vërtetuar nga DUMM.
4. Vendimin për Kushte Ndërtimore, me nr. 07-351/01-2816, të datës 02.08.2017, të lëshuar nga DUMM.
5. Elaborati gjeomekanik për ndërtimin e Shëpisë së azilit të pleqëve, me Investitor Kisha Katolikem, Kuvendi Franqeskan, i punuar nga IMK "Ballkan Project" - Prishtinë.
6. Akti Noterial – Autorizim me numër LRP nr. 1229/2017, i datës 24.03.2017.
7. Pëlqimin Sanitar me nr.14/530/01-22658, dt.17.11.2017, nga Inspektoriati Sanitar Komunal- Drejtoria e Inspeksionit e Komunës së Gjakovës.
8. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.14/17, me datë 31.10.2017, lëshuar nga Departamenti i Parandalimit, Axhencia e Menaxhimit Emergjent, Ministria e Punëve të Brendshme, RKS.
9. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, me nr.1775, dt.31.10.2017.
10. Pëlqimin nga K.R.U. "Radoniqi" Sh.A.-Gjakovë, me numër 3002, të datës 27.10.2017.
11. Pëlqimin nga PTK –Vala, me nr. zyrt. dt.18.10.2017.
12. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar byroja projektuese "KORONA – ING" - Gjakovë.

I liruar nga taksa administrative, në bazë Nenit 5, paragrafi 5.15. nën paragrafi b), të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale, me nr. 01 Nr.011-43964/2015, dt.30.06.2015.


KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspeksionit ,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani, jur. i dipl.



U.D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxh. e dipl.e ark.




KOPJE PLANI

Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtorja për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë

Zona kad. GJAKOVË QYTET

Shk. zvog. 1: 2500

Poseduesi: SEKRETARIATI FED. PER MB. POPULLORE - KUVENDI FRANCESKAN KISHA KATOLIKE SHFRYTEZUESE
99 VITE



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m	
3206-3			Jepjellore		1	14	37	
Gjithësejtë					1	14	37	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

Gjakovë 08 02 të vitit 2017

VERIFIKON:

K.K. GJAKOVË

Z.K. : Gj.QYTET

Ng. nr. 3203-0,3204-0,3206-3.


PLAN SITUACIONI

**Lokacioni: Shtëpia e përkujdesit
ndaj të moshuarëve**

Gjakovë, 02.08.2017

punoi: Fatmir Bobi, tek.gjeod.

vërtetoi: Agron Gojani, i.d.a.



15.09.2015
Gjeo. lic
Drilon Shllaku

P = 1 : 1000

Punoi : N.Sh.K e M"GEO-DD" Gjakovë
DREJTORI
Drilon Shllaku